



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 30 gusht 2024

Njoftim për shtyp

Zhvillime më të rëndësishme te institucionet tjera financiare¹ (ITJ): tremujori i dytë 2024

- **Totali i mjeteve të institucioneve tjera financiare (ITJ)**, në tremujorin e dytë të vitit 2024, arrin 235.202 milionë denarë që paraqet rritje tremujore prej 9.988 milionë denarë. Institucione tjera financiare kanë pjesëmarrje prej 21,3% në mjetet e institucioneve financiare². Brenda strukturës të ITJ, pjesëmarrjen më të madhe prej 65,3% në totalin e mjeteve e kanë fondet e pensioneve, pas së cilave janë kompanitë e sigurimit me pjesëmarrje prej 15.8%.
- **Në tremujorin e dytë të vitit, totali i mjeteve të institucioneve tjera financiare (ITJ)** shënojnë rritje tremujore dhe vjetore prej 4,4% dhe 19,4%, përkatësisht, kryesisht shkak i mjeteve më të larta të fondeve pensionale dhe kontribut shtesë kanë edhe fondet e investimeve. Zhvillimet pozitive në të dy bazët janë realizuar edhe te nënsektorët tjerë, me përjashtim të shoqërive për menaxhim me fondet pensionale dhe të investimeve, të cilat shënojnë rënie tremujore.

Tabela 1. Gjithsej mjete / detyrime të ITJ-së, sipas nënsektorëve

	T2.2023	T3.2023	T4.2023	T1.2024	T2.2024	ndryshime tremujore		ndryshime vjetore		Struktura (Totali i IF)	Struktura (Totali i ITF)
						T2. 2024/T1. 2024		T2. 2024/T2. 2023			
	gjendja, në milionë denarë					në milionë denarë	në %	në milionë denarë	në %	në %	në %
1. Institucionet financiare (ITD dhe ITF)	1,019,915	1,030,818	1,077,566	1,079,312	1,103,974	24,662	2.3	84,059	8.2	100.0	0
2. Institucione të tjera depozituese (ITD)	822,856	829,210	866,538	854,098	868,772	14,674	1.7	45,916	5.6	80.4	0
3. Institucionet të tjera financiare (ITF)	197,059	201,608	211,028	225,214	235,202	9,988	4.4	38,143	19.4	21.3	100.0
3.1 Fondet pensionale	128,683	131,729	138,867	147,562	153,521	5,959	4.0	24,838	19.3	13.9	65.3
3.2 Shoqëritë të sigurimeve	34,047	34,390	34,449	36,144	37,109	965	2.7	3,062	9.0	3.4	15.8
3.3 Fondet e investimeve	12,172	12,290	13,499	15,530	17,954	2,424	15.6	5,782	47.5	1.6	7.6
3.4 Shoqëritë financiare	10,091	10,642	11,191	11,564	11,837	273	2.4	1,746	17.3	1.1	5.0
3.5 Shoqëritë të lizingut financiar	9,777	10,208	10,559	11,789	12,268	479	4.1	2,491	25.5	1.1	5.2
3.6 Shoqëri administruese të fondeve pensionale dhe investuese	2,290	2,348	2,463	2,624	2,513	-111	-4.2	223	9.8	0.2	1.1

Burimi: BPRMV-ja.

¹ Në institucione tjera financiare janë të përfshira: fondet e investimit, fondet pensionale, kompanitë e sigurimeve, kompanitë për menaxhimin me fondet investuese dhe kompanitë për menaxhim me fondet pensionale, kompanitë financiare dhe kompanitë ofrues të lizingut financiar.

² Për nevojat e këtij njoftimi në kategorinë e institucioneve financiare (IF) janë përfshirë: institucionet tjera depozitare (ITD - bankat dhe kursimoret) dhe institucione tjera financiare (ITF).



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- **Pjesa më e madhe e mjeteve të ITJ-së** janë investime në letrat me vlerë të borxhit dhe kapitalit³ me pjesëmarrje prej 51,4% dhe 26,2%, përkatësisht, ndërsa në **a anën e detyrimeve** kryesisht janë detyrime të bazuara në rezervat teknike të sigurimit⁴ dhe llogarive kapitale, me pjesëmarrje prej 54,1% dhe 36,0%, përkatësisht⁵.

Tabela 2. Mjete/detyrime të ITJ-së, pas nënsektorëve dhe pas instrumenteve financiare, tremujori i dytë 2024

	Totali i ITF		Fondet pensionale		Shoqëritë të sigurimeve		Fondet e investimeve		Shoqëritë financiare		Shoqëritë të lizingut financiar		Shoqëri administruese të fondeve pensionale dhe investuese	
	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)
TOTALI I MJETEVE	235,202	-	153,521	-	37,109	-	17,954	-	11,837	-	12,268	-	2,513	-
I. Valuta dhe depozitat	17,838	7.6	4,085	2.7	7,136	19.2	5,257	29.3	598	5.0	340	2.8	423	16.8
II. Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	120,832	51.4	99,434	64.8	15,503	41.8	4,311	24.0	-	-	-	-	1,584	63.0
III. Kreditë	19,638	8.3	1	-	210	0.6	-	-	10,125	85.5	9,283	75.7	19	0.8
IV. Aksionet dhe kapitali tjetër	61,732	26.2	49,608	32.3	3,556	9.6	8,359	46.6	27	0.2	3	0.0	180	7.2
V. Rezervat teknike të sigurimit	2,458	1.0	-	-	2,458	6.6	-	-	-	-	-	-	-	-
VI. Derivatë financiare	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
VII. Kërkesa tjera	8,344	3.5	394	0.3	6,632	17.9	26	0.1	729	6.2	443	3.6	120	4.8
VIII. Mjetet jofinanciare	4,359	1.9	-	-	1,614	4.3	-	-	359	3.0	2,200	17.9	187	7.5
TOTALI I DETYRIMEVE	235,202	-	153,521	-	37,109	-	17,954	-	11,837	-	12,268	-	2,513	-
I. Kreditë	14,762	6.3	-	-	98	0.3	-	-	4,862	41.1	9,754	79.5	48	1.9
II. Rezervat teknike të sigurimit	127,197	54.1	104,111	67.8	23,086	62.2	-	-	-	-	-	-	-	-
III. Derivatë financiare	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
IV. Kërkesa tjera	8,463	3.6	91	0.1	3,742	10.1	324	1.8	2,845	24.0	1,249	10.2	211	8.4
V. Llogaria kapitale	84,781	36.0	49,319	32.1	10,184	27.4	17,629	98.2	4,130	34.9	1,265	10.3	2,254	89.7

Burimi: BPRMV-ja.

- **Në anën e mjeteve**, rritja tremujore në bazë tremujore kryesisht vjen si rezultat i rritjes së investimeve në letrat me vlerë të borxhit dhe kapitalit, me kontribut më të vogël të valutave dhe depozitave dhe kërkesave bazuar në kredi. Rritja në bazë vjetore vjen si rezultat i rritjes së investimeve në letrat me vlerë të borxhit dhe kapitalit, me kontribut më të vogël të kredive dhe kërkesave tjera. Nga ana e detyrimeve, rritja tremujore dhe vjetore është kryesisht rezultat i rritjes së detyrimeve në bazë të rezervave teknike të sigurimit dhe llogarive kapitale, dhe në një masë më të vogël të rritjes së detyrimeve të bazuara në kredi dhe detyrime të tjera.



³ Letrat me vlerë të borxhit (LVB) i referohen letrave me vlerë të ndryshme nga aksionet në pajtim me klasifikimin ndërkombëtar të instrumenteve financiare, siç është publikuar në bilancet dhe pasqyrat e institucioneve tjera financiare.

⁴Rezervat teknike të sigurimit përmbajnë: kapitalin neto të amvisërive në rezervat nga sigurimi i jetës, kapitali neto i amvisërive në fondet pensionale dhe premitë e parapaguara dhe rezervat kundrejt kërkesës për llogarimbajtje (sigurimi jojetë).

⁵Llogaritë kapitale i përfshijnë: investimet pronësore, fitimi i mbajtur, fitimi nga viti aktual, rezerva e përgjithshme dhe e veçantë dhe përshtatjet me vlerë.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë



Burimi: BPRMV-ja.

Zhvillime më të rëndësishme të ITJ, sipas llojeve të institucioneve

- Në tremujorin e dytë të vitit 2024, totali i mjeteve të fondeve pensionale⁶ (të detyrueshme dhe vullnetare) u rrit për 4,0% në nivel tremujor, kryesisht si rezultat i rritjes së investimeve në letrat me vlerë të borxhit dhe kapitalit, me një ndikim më të vogël pozitiv dhe monedhave dhe depozitave, ndërsa kërkesat tjera zvogëlohen. Rritja vjetore arrin në 19.3% dhe kryesisht vjen si pasojë e rritjes së investimeve në letrat me vlerë të borxhit dhe kapitalit, me një rritje më të ulët të kërkesave tjera dhe në kushtet e rënies së vërejtur në valutë dhe depozita. Në anën e detyrimeve, rritja tremujore dhe vjetore tërësisht vjen nga rritja e rezervave teknike të sigurimeve dhe të llogarive kapitale.**




Burimi: BPRMV-ja.

⁶BPRMV aktualisht e njoftojnë të gjitha fondet pensionale që janë të përfshira në regjistrin e Agjencisë për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS), nga të cilat tre të detyrueshme dhe katër vullnetare fondet pensionale.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në tremujorin e dytë, **totali i mjeteve të shoqërive të sigurimit**⁷, shënoi një rritje tremujore prej 2.7%, kryesisht si rezultat i rritjes së kërkesave tjera dhe letrave me vlerë të borxhit dhe në një masë më të vogël nga instrumentet e tjera, me përjashtim të valutave dhe depozitave që janë reduktuar. Rritja vjetore është 9.0% dhe kryesisht vjen si rezultat i rritjes së investimeve në letrat me vlerë të borxhit dhe kapitalit, ndërsa ndikim më të vogël pozitiv kanë edhe instrumentet tjera, me përjashtim të rezervave teknike të sigurimeve, të cilat shënuan rënie. Nga ana e detyrimeve, rritja tremujore dhe vjetore kryesisht është reflektim i rezervave më të larta teknike të sigurimit, me kontribut shtesë edhe të detyrimeve tjera dhe të llogarive kapitale.



Burimi: BPRMV-ja.


- **Totali i mjeteve të fondeve të investimeve**⁸, këtë tremujor, realizoi dhe rritje tremujore dhe vjetore prej 15,6% dhe 47,5%, përkatësisht. Ndryshimi në rritje në të dy bazat është kryesisht për shkak të rritjes së monedhave dhe depozitave dhe investimeve në letrat me vlerë të borxhit, me një kontribut shtesë nga investimet në letrat me vlerë të borxhit. Nga ana e detyrimeve, ndryshime të dy bazat vjen nga rritja e llogarive kapitale, ndërsa më pak nga detyrimet tjera.

⁷BPRMV-në rregullisht e njoftojnë të gjitha gjashtëmbëdhjetë kompanitë e sigurimit që janë të përfshira në regjistrin e Agjencisë për Mbikëqyrje të Sigurimit (AMS), nga të cilat njëmbëdhjetë për sigurim jojetë dhe pesë për sigurim të jetës.


⁸Në regjistrin e Komisionit të Letrave me Vlerë (KLV) aktualisht janë përfshirë njëzet e dy fonde investuese të hapura dhe një fond investues privat, me ç'rast në të dhënat janë përfshirë njëzet e tre fonde investuese.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë



- **Totali i mjeteve të shoqërive financiare^{9,10}**, në tremujorin e dytë të vitit 2024, realizoi rritje tremujore dhe vjetore prej 2,4% dhe 17,3%, përkatësisht. Mjetet e shoqërive financiare janë kryesisht kërkesa të bazuara në kredi, në vlerë prej 10.125 milionë denarë dhe në bazë tremujore dhe vjetore janë rritur për 0,2% dhe 17,1%, përkatësisht. Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve të shoqërive financiare vjen kryesisht nga kërkesat tjera, valutat dhe depozitat, ndërsa ndryshimi vjetor është kryesisht për shkak të rritjes së kredive dhe në masë më të vogël të kërkesave tjera. Në anën e detyrimeve, rritje tremujore vjen si rezultat i rritjes së detyrimeve tjera, me rritje edhe të detyrimeve në bazë të kredive, në kushte të rënies së llogarive kapitale. Rritja vjetore vjen kryesisht nga rritja e kredive, me një kontribut shtesë të llogarive kapitale dhe detyrimeve të tjera.




⁹Në të dhënat aktualisht janë përfshirë tridhjetë e pesë kompani financiare.

¹⁰Në tremujorin e katërt të vitit 2017 në seritë të dhëna është përfshirë kompani financiare e re (kursimore që regjistrohet në kompani financiare), ndryshimi që ka ndikim në normat vjetore të ndryshimit.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- **Totali i mjeteve të shoqërive ofruese të lizingut financiar¹¹**, shënoi rritje tremujore dhe vjetore prej 4,1% dhe 25,5%, përkatësisht. Pjesa më e madhe e mjeteve të këtij nënsektori janë kërkesa të bazuara në kredi, në vlerë prej 9.283 milionë denarë dhe më të larta për 7,0% në nivel tremujor, me rritje vjetore prej 23,6%. Rritja e totalit të mjeteve sipas dy bazave kryesisht rrjedh nga rritja e kërkesave sipas kredive dhe mjeteve jofinanciare, me valuta dhe depozita të reduktuara. Nga ana e detyrimeve, rritja tremujore dhe vjetore kryesisht është rezultat i detyrimeve më të larta të bazuara në kredi, ndërsa kontribut pozitiv kanë edhe llogaritë kapitale dhe detyrimet tjera.




Burimi: BPRMV-ja.

- Në tremujorin e dytë të vitit 2024, **totali i mjeteve të shoqërive administruese të fondëve pensionale dhe investuese** është ulur për 4,2% në nivel tremujor, pothuajse tërësisht si pasojë e rënies së valutave dhe depozitave. Në bazë vjetore, rritja është 9.8% dhe kryesisht vjen si pasojë e rritjes së investimeve në letrat me vlerë të borxhit, në kushtet e rënies së valutave dhe depozitave. Nga ana e detyrimeve, ndryshimi tremujor është reflektim i detyrimeve të tjera më të ulëta, në kushtet e rritjes së llogarive kapitale, ndërkohë që ndryshimi vjetor është më së shumti rezultat i rritjes së llogarive kapitale, dhe në masë më të vogël të detyrimeve të tjera.

¹¹ Në të dhënat aktualisht janë përfshirë nënëti kompani - ofrues të lizingut financiar.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë



Burimi: BPRMV-ja.

Rishikimi i të dhënave

Të dhëna për zhvillimin të ITJ-ja në këtë njoftim përmbajnë rishikime të dhënave nga tremujori i dytë i vitit 2023. Këto rishikime nuk shkaktojnë ndryshime të ndjeshme të të dhënave paraprakisht të publikuara dhe kryesisht rrjedhin nga përfshirja më e mirë dhe cilësia e raportimeve.

Informacione shoqëruese

Seri kohore të të dhënave: Të dhëna tremujore për mjetet dhe detyrimet e institucioneve financiare

<https://www.nbrm.mk/ns-newsarticle-bilans-i-pregledi-na-finansiskite-institucii-kvartalni-podatoci-al.nspix>

Shpjegime metodologjike:

https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia%20monetarna_07_2021_al.pdf

Informacion për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesit:

https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia%20monetarna_07_2021_al.pdf



**Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Drejtoria për Statistikë**

Publikimet e ardhshme: Kalendar për publikimin e të dhënave

https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_i_publicimit_t%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnave.pdf

Të dhëna tremujore për mjetet dhe detyrimet e institucioneve financiare: 29 nëntor 2024 (mesatare referuese me tremujorin e tretë 2024).

Për pyetje të gazetarësh, Ju lutemi kontaktoni me personat nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme në lidhje me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 113 (ose 108/110).